



☒ Të gjitha fjalët ☐ Të paktën një fjalë ☐ Fjalët ekzakt

Flash


Shkodër, raportohet për shpërthim tritol në lagjen 'Partizani'

**POP 5**

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



**1** Shkodër, shpërthim me tritol në një makinë të parkuar pranë derës së shtëpisë



**2** Lëkundje të lehta tërmeti në Durrës dhe Tiranë



që qëlloi Klodjan Rashën

**3** 'S'ka kryer shkelje dhe ka bërë njoftimin në kohë' Pas 2 javësh i pezulluar, kthehet në detyrë, kolegu i policit



ditën

Aktualitet

## Kanabis dhe arsenal armësh në Krujë, arrestohen 9 persona, mes tyre një polic, një në kërkim (VIDEO)

*Nga tërësia e veprimeve hetimore e procedurale ka rezultuar se këta persona në bashkëpunim me njeri-tjetrin kanë kultivuar bimë narkotike në një zonë të pyllëzuar të fshatit Shqezë të rrethit Krujë.*

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com



**Redaksia**

15 Korrik 2019, 15:07 | Përditesimi i fundit: 15 Korrik 2019, 17:54

Share 77

Tweet

**A<sup>+</sup> A<sup>-</sup>****Nje det me oferta te pret...****zbulo me teper ne [booking.adriaferries.com](https://booking.adriaferries.com)**

**KRUJË**- Nëntë persona, mes tyre një efektiv policie janë arrestuar në kuadër të operacionit të koduar “Ndëshkimi” për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike ku u sekuestruan disa bimë dhe arsenal armësh. Efektivi i policisë që ka rënë në pranga është Hysen Pula, 52-vjeç. Sipas burimeve Pula prej disa kohësh ka qenë në kontakt me grupin e kultivimit të kanabisit duke u krijuar atyre mbrojtje. Gjithashtu është vendosur të arrestohet edhe një tjetër person, i cili është personë në kërkim. Një tjetër person është shpallur në kërkim.

**RAPORTO!** Chat live  
me Shqiptarja.com

Nga tërësia e veprimeve hetimore e procedurale ka rezultuar se këta persona në bashkëpunim me njeri-tjetrin kanë kultivuar bimë narkotike në një zonë të pyllëzuar të fshatit Shqezë të rrethit Krujë. Gjithashtu, gjatë operacionit, si rezultat i kontrollit të banesave të këtyre personave dhe ambienteve përreth tyre, policia gjeti dhe sekuestroi 3 armë zjarri pushkë, 5 armë gjahu, municion luftarak dhe 17 aparate celulare.

[Sh]

LEXO EDHE:

.com



**Liroi nga burgu të dënuarit e përjetshëm, ILD  
kërkon shkarkimin e gjyqtarës Enkelejda Hoxha!  
KLGJ vendos më 8 janar**

#### Të arrestuarit;

V. B., 50 vjeç, banues në fshatin Mafsheq, Krujë.

R. B., 53 vjeç, banues në Fushë Krujë.

Sh. X., 48 vjeç, banues në fshatin Shqezë të rrethit Krujë.

M. K., 28 vjeç, banues në fshatin Shqezë të rrethit Krujë.

K. K., 46 vjeç, banues në fshatin Selitë të rrethit Kurbin.

B. I., 26 vjeç, banues në fshatin Malbardhë të rrethit Kurbin.

**Hysen Pula, 52 vjeç, banues në Krujë, Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Krujë.**

F. K., 58 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Shqezë, Krujë.

F. B., 35 vjeç, banues në fshatin Halile, Fushë Krujë.

Në kërkim është shpallur A. B. banues në fshatin Halile, për kultivim droge dhe armëmbajtje. Ndërkohë që në detyrim paraqitje u lanë; Y. K. Xh. B. dhe A. B. po për kultivim droge dhe armëmbajtje pa leje.

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com